

# **RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e integruar të studimit**

**“Master i Shkencave në Stomatologji”**

**Ofruar nga Univesiteti Aldent**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Prof.Asoc Etleva Qeli (Droboniku),**

**Dr.Shk Manola Kelmendi**

(shkurt/2017)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për akreditimin periodik te programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Aldent
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Dentare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 27.02.2008
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	Urdhër i MASH Nr.240, datë 26.05.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Stomatologji
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Aktivizimi i programit të studimit	2008
17	Numri i studentëve	1821 studentë
	Etj	



## **HYRJE**

### **Të dhëna për vlerësimin periodik të programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”**

Universiteti “Aldent” nisi veprimtarinë e tij si institucion arsimor në vitin 2003 si shkollë profesionale 2-vjeçare për laborant dentar.

Në vitin 2006 me VKM nr.673, dt.22.09.2006 jepet leja për hapjen e shkollës së Lartë Universitare Aldent.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 27.02.2008 është liçensuar programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në “Stomatologji”(5 vite akademike).

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr 539, date 13.06.2013 bëhet ndryshimi i statusit të Shkollës së Lartë Universitare në Universitetin “Aldent” dhe krijimi i dy Fakulteteve: Fakulteti Shkencave Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr.240, datë 26.05.2011 është akredituar programi i studimit Master i Shkencave në Stomatologji.

Departamenti i Stomatologjisë, në UAL është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Dentare

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

- Përbërja e GVJ:

1 Prof.Asoc Etleva Qeli

2 Dr.Shk Manola Kelmendi

Me datë 15.02.2017 është dërguar në Insttucion, Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 01.03.2017 Universteti Aldent përgjigjet nëpërmjet shkresës zyrtare që nuk ka vërejtje rreth Draft RVJ. Në këtë mënyrë Raporti merr formën e tij përfundimtare.

### **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**

#### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

a) Stafi pedagogjik duhet të krijojë kushte të motivoje, inkurajojë dhe nxisë studentet për rritjen e cilësisë së rezultateve

b) Të nxiten dhe mbështeten nga i gjithë stafi drejtues dhe pedagogjik studentët për një studim sistematik që do të çonte pa dyshim në rritjen e rezultateve të tyre.

c) Drejtuesit e institucionit duhen të rrisin më tej inkurajimin për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor si nga stafi akademik ashtu dhe nga studentët.

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

a-Për rekomandimin e parë institucioni ka rritur sipërfaqen e bibliotekës dhe numrin e literaturës (libra, revista, artikuj shkencorë) në dispozicion të studentëve. Prej disa vitesh studentët e secilit kurs mbikqyren nga një pedagog tutor i cili i orienton dhe i asiston studentët gjatë gjithë programit të tyre të studimit dhe nxit për një pjesëmarrje më aktive të tyre në jetën universitare në të gjitha fushat dhe format e saj. Shërbimi i tutoriatit funksionon në bazë të një rregulloreje të miratuar në mbledhjen e senatit dt 10/09/2015

b-Për rekomandimin e dytë institucioni ka riorganizuar shpërndarjen e orëve në lëndë të veçanta duke shtuar orët e projekteve si edhe ka hartuar një format vlerësimi dijesh për çdo pjesë përbërëse të lëndës/modulit. (shtojca nr 4) Page 3 of 67

c- Për rekomandimin e tretë, institucioni ka organizuar konferencën I-parë shkencore studentore. Prej tre vitesh aplikohet vlerësimi përfundimtar i studentëve me temë diplome , shumica e të cilave janë eksperimentale. Në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve është dhe biblioteka online Hinari. (shtojca nr 5)

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

Gjatë takimit të parë me titullarët e Universitetit, na u komunikua se: Universiteti "ALDENT", në gjithë veprimtarinë e tij, ka si mision: a) të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve; të formojë specialistë të lartë; b) të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë të gjithë jetës; c) të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal; ç) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë

Universiteti "ALDENT" në konsultim dhe lidhje të vazhdueshme me shumë profesionistë të njohur brenda dhe jashtë vendit ka synuar që studentëve t'iu krijojë kushte sa me optimale me qëllim që të arrijë misionin e tij.

Objektiva janë realizuar në bazë të një strategjie të përcaktuar qartë nga organet drejtuese të njësisë.

Objektivat e programit të studimit Master i Shkencave në Stomatologji në Fakultetin e Shkencave Dentare pranë Universitetit "Aldent", kanë synuar që studentët të pajisen me bazat shkencore të përgatitjes teorike e praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit në praktikën e përditëshme klinike.

Ky program studimi përfshin, veç njohurive të formimit të përgjithshëm, edhe njohuritë në lëndët profesionale si morfologjia dentare dhe njohuria materiale, protetike fikse dhe e lëvizshme, ortodoncia fikse dhe e levizshme, implantologji, dentistri, endodonti, kirurgji etj. Studentët fitojnë përvojë pune nëpërmjet praktikave profesionale që zhvillohen nga viti i dytë dhe deri në përfundim të studimeve të tyre.

Në funksion të qëllimit dhe objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në Stomatologji dhe rolit që kanë institucionet e arsimit të lartë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, departamenti i Stomatologjisë kryen aktivitete të vazhdueshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit për shoqërinë. Këto aktivitete përfshijnë trajnime, konferenca, seminare, aktivitete sociale e kulturore me profesorë vendas e të huaj.

Për të realizuar këtë program është i angazhuar një staf akademik ku japin mësim 18 pedagogë të brendshëm duke realizuar mbi 78% të ngarkesës mësimore. Raporti student / pedagog të brendshëm është 1/10.

### ***Vlerësimi sipas Standardeve***

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; <b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; <b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; <b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Mendojmë se programet janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit për të përgatitur mjek stomatolog dhe kanë objektiva të përcaktuara qartë si afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata. Mendojmë se programi i studimeve është i plotë, teorik dhe praktik duke realizuar plotësisht objektivat e tij. Në funksion të qëllimit dhe objektivave të këtij programi studimi ky institucion kryen edhe një sere aktivitete shkencore si trajnime, konferenca, seminare si dhe aktivitete sociale e kulturore. Ky program është hartuar në përputhje me kerkesat e tregut të punës për mjek stomatolog dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Mendojmë se programet e studimit që ofrohen në Universitetin "Aldent" janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; <b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe emërtimi i programit të studimit "Master i Shkencave në Stomatologji" është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; <b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Universiteti "Aldent" ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve dhe për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ pas vizitës në Universitetin Aldent dhe njohjes me dokumentacionin e vënë në dispozicion për programin e studimit Master i Shkencave në Stomatologji konkludon se ky program është i organizuar në përputhje me misionin, objektivat, strategjinë e institucionit si dhe legjislacionit në fuqi. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program studimi është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Universiteti “Aldent” ka hartuar plane strategjike për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve dhe për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

**2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

Struktura përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Stomatologji është Fakulteti i Shkencave Dentare i cili ka në përbërje këto njësi bazë:

Departamenti i Stomatologjisë;

Departamenti i Laborantëve Dentar;

Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik;


Fakulteti i Shkencave Dentare funksionon në bazë të Rregullores së vet të Brendshme e cila buron nga Statuti dhe Rregullorja e universitetit dhe bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor etj.

Në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit evidentohen qartë mënyrat e organizimit, modalitetet e funksionimit të veprimtarive pedagogjike, rregullat administrative dhe studentore, mekanizmat vendimmarrëse në linjën vertikale dhe horizontale, si dhe sigurimi i standardeve të cilësisë së brendshme dhe kërkimit shkencor.

***Vlerësimi i Treguesve të matshëm:***

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit





- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

1. DEKANI i Fakultetit të Shkencave Dentare - Dr.Sh. Edlira Dedaj
2. KËSHILLI I FAKULTETIT - Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor të fakultetit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet nga këta anëtarë:

Prof.Asc.Agron Meto (kryetar)

Dr.Sh. Edlira Dedaj (anëtarë)

Dr.Sh. Brunilda Koçi (anëtarë)

Prof.Asc.Arben Ndreu (anëtarë)

Msc.Orges Simeon(anëtarë)

Msc.Stela Panteqi (anëtarë)

Msc.Estela Halimi (anëtarë)

3. Përgjegjës i Departamentit të Stomatologjisë - Dr.shk Brunilda Koçi.

4. Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori i programit të studimit

Këshilli Drejtues i Stomatologjisë	Titulli	Pozicioni (anëtar/Kryetar)
Merita Bardhoshi	Prof.Asc.	Kryetare
Agron Meto	Prof.Asc.	Anëtar
Adem Alushi	Prof.	Anëtar
Diana Brovina	Prof.	Anëtar
Ruzhdie Qafmolla	Prof.	Anëtar
Orges Simeon	Msc.	Koordinator i Stomatologjisë

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se nuk ka ndryshime nga të dhënat e deklaruara nga institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për këta tregues.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se Universiteti “Aldent” është organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi në dy fakultete, në Fakultetin e Shkencave Dentare dhe në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në bazë të urdhërit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.305, datë 24.07.2013 “Për riorganizimin e Universitetit “Aldent”. Fakulteti i Shkencave Dentare ka në përbërje këto njësi bazë:  Departamenti i Stomatologjisë;  Departamenti i Laborantëve Dentar;  Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik;  Në përbërje të Departamentit të Stomatologjisë ka 9 personel akademik efektiv nga të cilët 1 Prof, 2 Prof.Asc,2 Dr.Shk,2 SPA,2Msc.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion u njohëm me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të cilat bëheshin sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga departamenti. Dekanati në bashkëpunim me departamentin përcaktojnë kriteret specifike për pozicionin e punës. Gjatë procesit të rekrutimit komisioni i ngritur në nivel fakulteti merr në shqyrtim kandidaturat.Rekrutimi bëhej pas një konkursi ku vlerësohej kandidati me sistemin e pikëzimit sipas kriterëve(titull,grada,botime,referime shkencore, eksperiencë në punë rekomandime,intervista).Kandidaturat e renditura sipas pikëve i dërgohen për miratim Dekanit të Fakultetit përkatës, së bashku me dokumentacion e plotë të kandidatëve për pozicionin përkatës i cili ia përcjell për miratim Senatit Akademik. Senati shqyrton propozimet e miratuara të Dekaneve dhe në bazë të</p>



	<p>vendimit në senat, Rektori me pëlqimin e Administratorit të Përgjithshëm vendos emërimin në pozicionin përkatës kandidatit fitues.</p> <p>Kandidati fitues njoftohet për vendimin dhe nënshkruan kontratën individuale të punës për vitin akademik.</p> <p>Institucioni kishte një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Pas vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar GVJ konstaton se Universiteti “Aldent” është organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi .Departamenti I Stomatologjisë ka 9 personel akademik efektiv nga të cilët 1 Prof, 2 Prof.Asc,2 Dr.Shk,2 SPA,2Msc.</p> <p>Institucioni, për rekrutimin e personelit, ndjek procedurë ligjore dhe transparente të bazuara në rregulloren e brendshme të tij dhe procedurë të rekrutimit. Për personelin akademik,ndihmës mësimorë-shkencorë, administrativë, zyra e Burimeve Njerëzore disponon një bazë të dhënash të plota .</p>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Gjate vizitës në institucion GVJ u njoh me personelin akademik, personelin administrativ ndihmës. Departamenti i Stomatologjisë përbëhet nga 9 personel akademik efektiv nga të cilët: 1 Prof, 2 Prof.Asc,2 Dr.Shk,2 SPA,2Msc. dhe 10 personel akademik me kontratë nga të cilët 2 Prof,2 Prof.Asc,2 Dr.Shk,2 SPA,2Msc. Stafit akademik efektiv plotëson më shumë se 78% të orëve mësimore të programit të studimit. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik është në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimin Nr. 20 datë 09.05.2008 e MASH. Raporti personel akademik /student 1/10. Në ndihmë të procesit mësimor angazhohet një personel administrativ dhe ndihmës i përbërë nga 11 punonjës.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Departamenti i Stomatologjisë është përgjegjës për programin e studimit “Master në Stomatologji”

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Nga vizita në institucion dhe mbështetur në RVB konstatojmë se nuk ka ndryshime nga të dhënat e paraqitura në Tabelat 1 dhe 2 në Aneks 1/2,

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit

Nga vizita në institucion dhe mbështetur në RVB konstatojmë se nuk ka ndryshime nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 3, Aneksi 3

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Nga vizita në institucion dhe mbështetur në RVB konstatojmë se nuk ka ndryshime nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 4, Aneksi 4

- Të dhënat sipas seksit

Nga vizita në institucion dhe mbështetur në RVB konstatojmë se Personeli Akademik Efektiv është i përbërë nga 6 femra dhe 3 meshkuj, ndërsa Personeli Akademik me Kontratë është ipërbërë nga 6 femra dhe 4 meshkuj.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga vizita në institucion dhe mbështetur në RVB konstatojmë se nuk ka ndryshime për sa i përket moshës së personelit nga të dhënat e paraqitura në tabelën 5 te RVB.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në vizitën në institucion, GVJ u njoh me kontratat e punës të personelit akademik të cilatishin pjesë e dosjes individuale të personelit. Kontrata ishte e plotë ku parashikoheshin të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit dhe punëdhënësit. Nuk kishte ndryshime nga kontrata e paraqitur nga instucioni në shtojcën 8 të dokumentacionit të dorëzuar pranë APAAL.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në vizitën në institucion GVJ u njoh me stafin ndihmës/ administrativ. Konstatuam se nuk kishte ndryshime nga të dhenat e paraqitura në RVB për stafin ndihmes/ administrativ. Stafi përbëhet nga sekretarë, ekonomistë, mirëmbajtës, IT, sanitarë në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.

#### ***Vlerësimi sipas Standardeve***

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Mendojmë se stafi akademik(efektiv dhe me kontratë) që realizon procesin mësimor zotëron aftësi të larta akademike (tituj dhe grada) dhe është i angazhuar në përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Ky staf është i angazhuar edhe në detyrat administrative të institucionit. Ky staf mbështetet nga strukturat e UAL në realizimin e objektivave të programit të studimit. Stafi akademik është i angazhuar jo vetëm në realizimin e formimit teorik të studentëve, por është i përkushtuar edhe në formimin praktik të tyre duke nxitur vazhdimisht dashurinë për profesionin .Pranë UAL funksionon qendra e shërbimit klinik e cila ju ofron të gjithë studentëve të Fakultetit të Shkencave Dentare praktikën klinike profesionale në pacientë. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në</p>	<p>Në takimin me stafin akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik kishte liri akademike duke garantuar zhvillimin e lirë, krijues të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe në respekt të programeve dhe planeve mësimore të hartuara dhe miratuara sipas përcaktimeve që ai ka. Autonomia dhe liria akademike</p>

<p>përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>ne UAL funksionon mbi bazën e Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe statutit dhe rregullores se UAL.          Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe merr vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve nëpërmjet organeve drejtuese.          Në rregulloren e fakultetit, institucioni ka të përcaktuar qartë rregullat për përgjegjësitë, detyrat sipas funksioneve respektive.          Rekrutimi i personelt të ri dhe ngarkesa mesimore ishte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;  <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;  <b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;  <b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se Fakulteti i Shkencave Dentare për të plotësuar nevojat e programeve të studimit për staf akademik, ndihmës shkencor dhe administrativ ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit ‘Aldent’ .          Në vizitën në institucion, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit. Kjo procedurë kryhej në disa faza:          Departamenti është përfshirë në procesin e rekrutimit të stafit akademik, i cili parashtron në përputhje me ngarkesën mësimore kriteret bazë specifikisht për vendet vakante. Dekanati pasi merr kriteret nga departamenti bën njoftimin në faqet elektronike të punësimit, shpall dorëzimin e dosjeve konkurruese dhe pasi mbyllet ky proces, ngrihet komisioni me 5- vetë. Komisioni shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të rënë dakort më parë me 100 pikë, të ndarë sipas titullit, gradës, eksperiencës së punës, rekomandimet, intervista mbi bazë të së cilës klasifikon kandidatët në bazë të kriterëve të kërkuara dhe përputhshmërisë me pozicionin e përshkrimit të vendit të punës.          Kandidaturat e renditura sipas pikëve i dërgohen për miratim Dekanit të Fakultetit përkatës, së bashku me dokumentacion e plotë të kandidatëve për pozicionin përkatës i cili ia percjell për miratim Senatit Akademik. Senati shqyrton propozimet e miratuara të Dekaneve dhe në bazë të vendimit në senat, Rektori me pëlqimin e Administratorit të Përgjithshëm vendos emërimin në pozicionin përkatës të kandidatit fitues. Kandidati fitues njoftohet për vendimin dhe nënshkruan kontratën individuale të punës për vitin akademik.          Vëmë re se institucioni i ka dhënë përparësi rekrutimit dhe punësimit të personelit akademik të kualifikuar me grada dhe tituj shkencore, specializime dhe kualifikime. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin Master në Stomatologji përbën më shumë se 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi.          GVJ në vizitën në zyrën e burimeve njerëzore të Institucionit, konstatoi se Institucioni disponon një</p>

	bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.
<b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Ne Fakultetin e Shkencave Dentare përgjegjësi i Departamentit të Stomatologjisë ka gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Titullarët e lëndëve në programin e studimit “Master në Stomatologji” në 90 % kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”</p> <p>Titullarët dhe pedagogët e lëndëve në programin e studimit “Master në Stomatologji” në UAL kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi.</p> <p>Rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve; Institucioni ka siguruar personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale të vitit të III,,IV,,V e cila kryhet në Qendrën e Formimit dhe Shërbimit Klinik.</p>
<b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10</p>	<p>Në vizitën në institucion GVJ konstatoi se studentët që ndjekin këtë program studimi kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Pedagogët udhëheqës kanë të gjithë gradën “Doktor”. Pedagogët udhëheqës nuk kanë më shumë se 7 tema diplome nga të cilat, 5 janë tema eksperimentale.</p>

<p>(dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. <b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Kostatuam se udhëheqësit e temave të diplomave ishin të specializuar në fushën studimore në të cilën ofrohet ky program. Udhëheqësit janë me grada dhe tituj akademik dhe specialistë në fushën përkatëse të tezës me eksperiencë klinike dhe në mësimdhënie.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; <b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në programin e studimit “Master në Stomatologji” një vend të rëndësishëm në kurikul zënë laboratorët dhe praktikat profesionale. Nga vizita në Institucion u konstatua se laboratorët dhe praktikat klinike profesionale realizoheshin me rigorozitet nga stafi akademik Të gjithë studentët ishin të angazhuar në praktikat klinike të asistuar nga stafi akademik dhe ndihmës mësimor-shkencor. Në praktikat klinike në vitin e III,IV,V studentët trajtonin raste klinike sipas protokolleve të mjekimit dhe i dokumentonin në kartelat e pacientëve duke krijuar një bazë të dhënash të cilën e shfrytëzuan për qëllime studimore.Trajtimi i pacientëve nga studentët kryhej falas. Studentët kryenin praktika profesionale jashtë auditorëve për një periudhë të caktuar kohe. Stafi akademik dhe ai ndihmës mësimor është i angazhuar në përmbushjen e objektivave të këtij programi</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi; <b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore e cila është e shpërndarë në përputhje me titullin,gradën shkencore,specialitetin përkatës duke respektuar Udhëzimin Nr.20 date 09/05/2008. Në të përfshihen orë mësimore në auditor, orë për punë administrative, orë për kërkim shkencor dhe për veprimtari të tjera mbështetëse. 78% e orëve mësimore të këtij programi studimi</p>

me orë mësimore.	realizohet stafi akademik efektiv.
<b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit e cila përditesohet vazhdimisht.</p> <p>Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Të dhënat e personelit, burimet njerëzore të institucionit, krahas dokumentacionit shkencor i ruajn edhe në sistemin informatik.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>GVJ pas njohjes me dokumentacionin e dorëzuar në APAAL dhe vizitës në institucion, konkludon se: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre</p> <p>Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p> <p>Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe realizon ngarkesën mësimore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Të gjithë studentët në përfundim të studimeve përgatitin një tezë studimore të udhëhequr nga një udhëheqës me titull/gradë dhe të specializuar në fushën përkatëse.</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit</p>	

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Në vizitën në institucion, GVJ vizitoi sallat e leksioneve, labororet për lëndët dhe praktikat profesionale, klasat për seminare, laboratorin e informatikës, bibliotekën, sekretarinë, bibliotekën online, nyjet hidrosanitare, mjediset shlodhëse, kafeteritë etj.

Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve me kapacitet 30-80 studente janë të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Klasat janë të mobiluara me karrige të pajisura me tavoleta. Ndriçimi natyral dhe ai artificial janë të bollshme. Dritaret janë të pajisura me grila nga brenda, për të krijuar mundësinë e projeksionit gjatë zhvillimit të mësimin.

Studentët e programit "Master në Stomatologji" i zhvillojnë labororet dhe praktikat profesionale klinike në labororet e disiplinave përkatëse (Laboratori i Anatomisë dhe Histologjisë, Laboratori i protetikes fikse, laboratorin e ortodontisë paraklinike, Laboratori i Morfologjisë Dentare, Laboratori i Protetikës së lëvizshme, Laboratori i Dentistrisë Paraklinike, Laboratori i Dentistrisë Restorative dhe Endodontisë, Laboratori i Kirurgjisë dhe Implantologjisë)

Në laboratorët e lëndëve klinike, studentët e vitit të katërt dhe të pestë punojnë në paciente realë në 10 unite dentare, rastet e ndryshme që paraqiten pranë klinikës universitare. Laboratorët e lëndëve klinike ishin të pajisur më së miri me instrumentar, llampa halogjene, grafi dixhitale, materiale të ndryshme dentare, aparatura për kontrollin e infeksionit.

Gjate vizitës në laboratorët e lëndëve klinike, GVJ i gjeti studentet duke manipuluar në pacientë nën mbikqyrjen e pedagogëve. Të gjithë studentët ishin të angazhuar me pacientë.

GVJ vizitoi laboratorët e lëndëve paraklinike ku konstatoi se këto laboratore ishin të pajisur me manekinë, poste pune, mulazhe, modele allçie, aparatura dhe instrumentarë bashkëkohorë të nevojshëm për realizimin e procedurave laboratorike për dizenjimin e një punimi protetik fiks dhe të lëvizshëm, aparateve ortodontike, kaviteve të Black-ut, kaviteve endodontik.

Këta laboratorë janë të organizuar, me të gjitha hapësirat e nevojshme për realizimin e laboratorëve perkatës paraklinikë.

Në dispozicion të personelit akademik kishte zyra komode të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për punë dhe studim.

Për studentet funksiononte biblioteka e pajisur me libra profesionale, kompjutera. Studentët shfrytëzonin bibliotekën online HINAR (biblotekë e OBSH) ku institucioni është abonuar.

Të gjitha ambientet ishin të pajisura me sistem ngrohje-ftohje, sistem kamerash, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Mjediset për Programin e studimit

Gjate vizitës në institucion, GVJ konstatoi të njëjtën gjendje me të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues në tabelën 7 të RVB

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

- Mjediset për stafin:

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi të njëjtën gjendje me të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues në tabelën 7 të RVB

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti “Aldent” ka një vendndodhje në qendër të Tiranës. Kjo vendndodhje është e arritshme për studentet, stafin ,pacientet.Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit prej 14 vitesh.</p> <p>Gjate vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAL siguron kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara në planin mësimor te programit Master i Shkencave në Stomatologji.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Biblioteka kishte literaturë të mjaftueshme në gjuhë të huaj që pasurohej në mënyrë periodike (revista shkencore, libra të shtëpive botuese Elsevier, Masson, etj).</li> <li>-Biblioteka kishte literaturë të autorëve shqiptarë (tekste mësimore,monografi,Revista Stomatologjike Shqiptare.</li> <li>-Është e disponueshme si për studentët dhe stafin akademik biblioteka online «Hinari» që ndihmon në realizimin e programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës se diplomes.</li> <li>-Biblioteka kishte orare të shërbimit në përshtatje me</li> </ul>



<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p> <p>Shtimi i titujve të librave, periodikëve, bëhej në bashkëpunim me titullarët e lëndëve dhe stafin në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim.</p>
--	---

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Gjate vizitës në institucion, konstatuam se institucioni kishte në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor</p> <p>Labororet e lëndëve paraklinike dhe klinike ishin të pajisur më së miri me aparatura bashkëkohore (manekinë, poste pune, mikromotora, mulazhe, unite dentare, aparatura tv kontrollit të infeksionit, instrumentar, materiale dentare etj).</p> <p>Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion të studentëve salla leksionesh, klasa, laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore për realizimin e programit të studimit "Master në Stomatologji".

Të gjitha sallat, labororet, mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit aparatura bashkëkohore dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e laboratoreve, praktikave klinike të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e tij.

Biblioteka e pasur me tituj librash dhe revista shkencore është vënë në shërbim të studentëve në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojat të studentëve. Është e disponueshme si për studentët dhe stafin akademik biblioteka online «Hinari» .

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

Universiteti Aldent është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Nga vizita në institucion ne mësuam se të ardhurat e UAL kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Burimi i financimit të UAL janë tarifatat e studentëve. Rritje kanë pësuar edhe investimet, shpenzimet si dhe kostot për student. Qëllimi kryesor i

përdorimit të fondeve në këto vite ka qenë investimi në infrastrukturë, pajisje, aparatura, tituj librash, abonimi në bibliotekën online, burime njerezore etj .

Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët ne mësuam që studentët nuk paguajnë kosto shtesë përveç tarifës së shkollimit, si për:

- Ridhënien e provimeve, përsëritjen e vitit shkollor (për 1 vit)
- Për pajisjen me dokumentacione si vërtetime, transferime, crregjistrime, diplomime, etj
- Për pagesa jashtë afatit të kontratës, për praktika mësimore .
- Aktivitete kulturore dhe sportive që organizohen nga shkolla.
- Financimi për veprimtari shkencore si për ato të organizuara nga UAL
- Aktivitete shkencore si Summer School, Winter School, etj.

Institucioni ka kryer donacione me karakter humanitar si sponsorizim për rikonstruksionin e pavionit të Fizioterapisë pranë QSUT, Rikonstruksion i çerdhes nr.23 në vartësi të Bashkisë së Tiranës si dhe donacionet e ndryshme në raste fatkeqsish natyrore, për fëmijët jetimë etj.

#### ***Vlerësimi i Treguesve të matshëm:***

GVJ konstaton se treguesit financiar përputhen me të dhënat e deklaruara nga institucioni në RVB (Tabela 8 në RVB)

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

#### ***Vlerësimi sipas Standardeve***

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Universiteti “Aldent” çdo vit bën një auditim (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës së tij financiare. Në këtë raport paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha të ardhurat e realizuara nga financimi i brendshëm (tarifat e studimit) si dhe detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, etj. Nëpërmjet këtij raporti analizohet eficaenca e përdorimit të të ardhurave në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.</p>
<p><b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton një bilanc të përvitshëm ku përshkruhen hollësisht të ardhurat që vijnë nga tarifat e shkollimit dhe kontribute të tjera financiare, ndarjen e këtyre burimeve financiare, etj.</p> <p>Universiteti Aldent disponon raportet financiare për pesë vitet e kaluara fiskale. Institucioni ka një stabilitet financiar dhe kapacitete të mjaftueshme për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe laboratorëve dhe gjenerimin e të ardhurave në shërbim të programit të studimit.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>  GVJ konkludon se institucioni ka një gjendje të qëndrueshme financiare në rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Ky institucion ka rritur shpenzimet, investimet, koston për student nga viti në vit duke përmirësuar infrastrukturën, duke rritur kapacitetet njerëzore në shërbim të programit të studimit.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Institucionet e arsimit të lartë sipas Ligjit të arsimit nr Nr.9741, datë 21.5.2007 janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Universiteti Aldent që në vitin akademik 2007-2008, ka parashikuar ngritjen e një strukture që do kishte si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimedhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që Universiteti ofron.

Ekzistenca e kësaj strukture është e paraqitur në Statut, Rregulloren e Brendshme të Universitetit Aldent, Rregulloren e vetë njësisë së SBC.

Në vizitën në institucion, GVJ u takua me anëtarët e njësisë së SBC:

1. Dr. Klodiola Dhama Kryetar i grupit të punës

2. Msc. Alba Koshovari



3.Msc. Mirela Tushe

4.Msc. Mirela Mucaj

5.Msc. Arselda Ziraj

6.Msc. Gerta Kupi

7.Rihana Terziu

Njësia e SBC kishte si objekt pune kryerjen e proceseve dhe aktiviteteve të saj me qëllim arritjen e besueshmërisë se mundet në çdo kohë, në mënyrë të vazhdueshme dhe konstante të ofrojë shërbime apo produkte që plotësojnë kërkesat e cilësisë së klientëve të saj (në këtë rast studentët, prindërit, universitet partnerë, shoqëria në përgjithësi, bizneset etj.) si dhe kërkesat e aplikueshme rregullatore (Ligji i Arsimit të Lartë, Udhëzimet e MASH, Kriteret dhe Rregullat e Akreditimit Kombëtar, etj.).

GVJ u njoh nga NJSBC me metodologjinë e ndjekur nga njësia për vlerësimin e punës në institucion. Njësia për vlerësimin e performancës së pedagogut përdor formularë me një set kriteresh (angazhimin e pedagogut në mësimdhënie, veprimtari shkencore, administrative etj), pyetësor për vlerësimin e matjes së kënaqësisë së studenteve, takime periodike, ditë të hapura, faqe interneti.

Anketimet janë realizuar çdo vit në periudhën e janarit përpara fillimit të sezonit të provimeve. Ato kanë qënë anonime. Numri i studentëve ka ardhur në rritje nga 120 studentë në vitin akademik 2011-2012 në 600 studentë në vitin akademik 2015-2016. Në vitin e fundit, anketimi dhe përpunimi i tij ishte realizuar online. Njësia e SBC ua ka raportuar Fakulteteve përkatëse problemet lidhur me rezultatet e pyetësorëve. Pedagogët janë vënë në dijeni të ankesave të studentëve dhe janë këshilluar që të marrin masa në drejtim të plotësisë me efektivitet në përputhje me normat profesionale dhe etike si dhe të ndjekin një rrugë sa më bashkëkohore për zhvillimin e mësimin për të zgjuar interesin e studentëve.

Institucioni kishte bërë të mundur krijimin e një sistemi online komunikimi (Google classroom) ku studenti logohet dhe shikon profilin e tij, listën e notave, kalendarin e provimeve, shkarkon leksionet e hedhura nga pedagogu përkatës, etj

Njësia e SBC ka trajtuar çështjet e pajisjes me dokumentacion të plotë të gjithë njësive akademike dhe administrative të universitetit, sipas kompetencave të çdo strukture. Gjithashtu njësia e SBC kryen auditime në strukturat mësimdhënëse dhe administrative dhe të dhënat e marra i raporton tek Rektori.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politika që ndiqet për përmirësimin e cilësisë në bazë të kontrolleve periodike është trajtimi dhe zgjidhja e çdo problemi që raportohet apo zbulohet nga auditimet e strukturave të institucionit apo nga pyetësorët e studentëve, vetë pedagogët apo hallkat më të larta drejtuese të institucionit.

Çdo anëtar i grupit vjetor të punës për njësinë e SBC përfaqëson njësinë strukturore të cilës i përket, qoftë mësimore apo administrative, dhe merr informacionin bazë të auditimit të kësaj strukture. Të gjitha problematikat dhe rezultatet diskutohen në mbledhjet periodike të grupit.

***Vlerësimi i Treguesve të matshëm:***

Nga vizita në institucion, takimi me njësinë e SBC, GVJ konstaton se nuk ka ndryshime nga të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (Tabela 5 në RVB). (tabela 4 në Aneksin 5 bashkangjitur këtij Raporti)

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm
  - Etj

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### *Vlerësimi sipas Standardeve*

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p>Të tërthorta:</p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p>	<p>Institucioni ka njësinë e SBC e cila monitoron sigurimin e cilësisë në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimit. Këto informacione janë të përfshira në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Kvto informacione janë transparente.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimeve, institucioni përdor metoda të tërthorta si anketime online në kushte anonimati, intervista etj, metoda të drejtpërdrejta si diskutime të hapura me studentët në lidhje me procesin mësimor etj</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet sipas formave të përcaktuara ligjore të cilat janë pjesë e Statutit, Rregullores së Universitetit dhe Programeve të studimit. Këto vlerësime dokumentohen në formën e proces-verbaleve të cilat janë në përputhje me legjislacionin</p> <p>Testimet , Seminaret, Detyrat e Kursit, Projektet, Prezantimet në Power Point, etj janë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve .</p> <p>Studentët gjatë Praktikave laboratorike mbikqyren dhe vlerësohen nga tutorët.</p>

<p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Çdo vit NJSBC e Universitetit “Aldent” harton një raport vjetor mbështetur në të dhënat e mbledhura dhe përpunuara nga anetarët e NJSBC-së.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Çdo vit institucioni harton një analizë vjetore mbështetur në raportin e NJSBC-së për ecurinë e programit të studimit.</p> <p>Mbështetur në këto rezultate, institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti “Aldent” është akredituar në nivel institucional Urdhëri i MAS nr 111 datë 11/03/2016. Ky institucion përdor NJSBC për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve që ofron. Kjo njësi kryen një vlerësim periodik të cilësisë së programeve duke përdorur instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë. NJSBC punon në mënyrë të vazhdueshme me personelin dhe studentet duke synuar njohjen e tyre me standartet e cilësisë, rëndësinë që ato kanë. UAL në bashkëpunim me NJSBC harton, zbaton dhe publikon strategjitë që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>  GVJ, nga vizita në institucion dhe takimi me NJSBC konstatoi se institucioni është i angazhuar në sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se Institucioni është angazhuar në sigurimin e cilësisë që në fillimet e tij. Të dhënat e siguruar nga NJSBC me anë të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta i shërbejnë institucionit për të hartuar dhe zbatuar strategji të reja për përmirësimin e cilësisë. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

Misioni i programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” është të përgatisë stomatologë me formim të spikatur teoriko – praktik, të aftë që të përballojnë kërkesat gjithmonë në rritje të sistemit tonë mjekësor në përgjithësi dhe atij stomatologjik në veçanti.

Objektivat e këtij programi janë që në fund të ciklit pesë vjeçar , studentët e diplomuar të kenë njohuri të mjaftueshme mbi:

- Bazat e Anatomisë, Fiziologjisë, Biokimisë dhe shumë aspekteve të tjera normale të organizmit.
- Aspektet fiziopatologjike të organizmit si dhe njohuri mbi disa nga sëmundjet kryesore të tij.
- Mbi grupet e ndryshme të medikamenteve, origjinën e tyre, mënyrat e përthithjes dhe eliminimit nga organizmi.
- Njohuri të përgjithshme për sëmundjet e brendshme dhe kirurgjikale



Në fushën e përgatitjes profesionale të kenë përthithur njohuri të mjaftueshme mbi:

- Dentistrinë restorative dhe preventive; materialet dhe metodat e përdorura për parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve të indeve të forta dhe të buta të dhëmbëve.
- Protetike paraklinike dhe klinike, ku përfshihet protetika fikse, protetika e lëvizshme, llojet e ndryshme të protezave, klasifikimi i tyre, dhe kujdesi gjatë konstruktimit të tyre
- Anesteziologjia dhe kirurgjia orale e maxillo-faciale, llojet e anestetikëve, teknikat e anestezisë, ekstraksionet dhe mjekimi i patologjive të lindura dhe të fituara në regjionin OMF
- Kërkesat ligjore që lidhen me aktivitetin e një klinike dentare
- Organizimin e aktivitetit në klinikat publike dhe private
- Aspektin etik, deontologjik dhe human të profesionit të stomatologut.

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” studimi është organizuar në 5 vite akademike, në 10 semestra, ku ka lëndë ose module që përfundojnë në një semestër dhe të tjera që shtrihen gjatë gjithë vitit.

Ky program studimi ka 300 ECTS ku 1 ECTS është e barazvlefshme me 25 orë mësimore punë të studentit dhe 1 orë mësimore zhvillohet 60 minuta. Në fund të studimeve 5-vjecare, studenti diplomohet me titullin: “Master i Shkencave në Stomatologji”. Cdo vit titullarët e lëndëve depozitojnë te përgjegjësi i departamentit syllabuset e lëndës. Literatura për cdo lëndë të programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” përzgjidhet nga pedagogu titullar i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Si literaturë përdoren:

-cikle leksionesh

-Tekste (botime) të hartuara nga vetë pedagogët e Fakultetit.

-Tekste plotësuese në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj të përshtatshme për t’u përdorur nga studentet.

Rekomandimi i literaturës nga ana e pedagogut bëhet me mjaft kujdes, duke ju referuar një bibliografie të gjerë me autorë tekstesh universitare kryesisht ato të UT apo të vendeve të tjera perëndimore.

Në të gjitha këto lëndë përveç leksioneve dhe seminareve, projekteve është planifikuar një numër i mjaftueshëm orësh për praktikën laboratorike, me qëllim që studentët të aftësohen jo vetëm teorikisht por edhe praktikisht.

Në program janë parashikuar edhe kredite të mjaftueshme të praktikës profesionale e cila do të bëhet në vitin e tretë, katërt dhe të pestë. Praktika i kanë mundësuar studentëve të punojnë në klinika të ndryshme publike dhe private dhe të aftësohen për punën që do të bëjnë pas diplomimit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)



- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
  - Për leksionet 6-12 orë në auditor dhe 19-13 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Laboratorët 18-25 orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikat lëndore 1-2 orë në auditor dhe 24-23 orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikën Profesionale 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar 10 orë në auditor dhe 1.5 orë punë e pavarur e studentit
  - Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licënuara (Tabela 6, Aneksi 6)

GVJ konstatoi se nuk ka ndryshime të gjendjes së konstatuar në institucion me të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

(Tabela 7, Aneksi 7)

GVJ konstatoi se nuk ka ndryshime të gjendjes së konstatuar në institucion me të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.
- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

GVJ konstatoi se nuk ka ndryshime të gjendjes së konstatuar në institucion me të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues.

*Vlerësimi sipas Standardeve*

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek kete program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale,</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” i UAL i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe i mundëson studentëve dhe stafit trajnime, seminare,workshope profesionale.</p> <p>Nga informacioni që morëm në institucion, studentët e diplomuar në vite rezultojnë të suksesshëm (95% e tyre marrin provimin e licensimit që në herën e parë) dhe fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit të stomatologut. Në këtë program studimi, studentët marrin njohuri në fushën e biostatistikës, metodave të kërkimit shkencor, të cilat u shërbejnë për të mbrojtur në fund të ciklit pesë vjeçar temen e diplomës. Punimet e diplomës janë të tipit teorik dhe eksperimental. Ato realizohen nga studenti nën mbikqyrjen e pedagogut udhëheqës. Të gjithë studentët mbrojnë temë diplome.</p>

<p>të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;  <b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja programit të studimit Master i Shkencave në Stomatologji është në përputhje me nivelin e studimeve që ofrohet dhe objektivave të tij.  Vlerësimi i studentëve realizohet nëpërmjet kontrollit të njohurive (kolokiume, detyrat e kursit, provimet praktike, provimet përfundimtare). Këto rezultate dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin 5- vjeçar të studimeve.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;  <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;  <b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” i UAL është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;  <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;  <b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;  <b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” përfshin aftësimin profesional me anën e orëve të shumta laboratorike dhe praktikave profesionale.  Të gjithë studentët përfshihen në kërkimin shkencor duke përgatitur vetë temën e diplomës nën mbikëqyrjen e udhëheqësve shkencor me grada dhe tituj.  Ky program studimi është i hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>Në vizitën në institucion, GVJ mësoi se numri i i pranimeve të reja në vitin e ri akademik në programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji ” bëhej duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës.</p> <p>UAL kishte marrë pjesë në Panairin e Orientimit të Karrierës të organizuar për herë të parë nga MAS në maj 2016.</p> <p>Universiteti Aldent kishte ngritur zyrën e këshillimit të karrierës e cila organizon aktivitete ku studentët e informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi .</p> <p>Institucioni dispononte të dhëna në lidhje me punësimin e të diplomuarve në këtë program në përputhje me diplomën.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron programe studimi që synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Programi i integruar i ciklit të dytë, Master i Shkencave në Stomatologji realizohet me 300 kredite ECTS në kohëzgjatje 5 vite akademike.</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>GVJ në takimet në institucion konstatoi se titullaret e lëndëve në fillim të çdo semestri , informojnë studentët mbi përmbajtjen e syllabuseve dhe ata kanë të drejtë të kenë një kopje të shkruar apo elektronike.</p>

**Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.**

**Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Në fillim të vitit të fundit të studimeve, çdo student plotëson disa formularë ku përzgjedhin fushën e kërkimit, temën , udhëheqësin shkencor. Temat miratohen nga dekani. Tema dorëzohet në një afat të caktuar para mbrojtjes përfundimtare. Për tezën e diplomës janë parashikuar 22 kredite ECTS në planin mësimor.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ konstaton se institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i i pranimeve të reja në vitin e ri akademik në programin e studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji ” bëhej duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës.

Studentet njihen në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës me syllabusin e saj dhe ata kanë të drejtë të kenë një kopje të tij të shkruar ose në format elektronik.

Ky program studimi përfshin aftësimin profesional nëpërmjet praktike klinike dhe profesionale dhe kërkimit shkencor. Te gjithë studentët në përfundim të diplomës përgatitin një temë diplome për të cilën janë parashikuar 22 kredite.

Institucioni duhet të marrë masa që kreditet e parashikuara për tezën e diplomës të jenë konform kriterit (30-40 kredite)

**8. Mësimdhënia**

Në planin mësimor te programit te studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji ” janë këto forma kryesore të studimit:

**Leksione.** Zhvillimi i orëve teorike është një nga format bazë të trajtimit të lëndëve. Bazuar në rregulloren e studimit të Universitetit “Aldent”, ndjekja e leksioneve nga studentet është e detyrueshme në mbi 75% të orëve.

**Seminare/Ushtime.** Vlerësohen njohurite e fituara nga studenti. Pjesëmarrja është e detyruar në masën 75 % të orëve të përgjithshme të seminareve, që parashikohen në planin mësimor për një lëndë të caktuar.

**Projekte.** Projektet prezantohen nga studentët në fund të semestrit. Dorëzimi i tyre është i detyrueshëm përpara provimit përfundimtar.

**Praktika laboratorike.** Zhvillohen gjatë gjithë vitit dhe kanë si qëllim përvetësimin e njohurive praktike nga studentët. Frekuentimi është 100 %.

Ky program studimi përfshin dhe forma të tjera të mësimdhënies si: leksione interaktive, konsultime, detyra kursi si punë e pavarur e studentëve jashtë auditorit.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha sallat, laboratoret, mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. aparaturo bashkëkohore dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e laboratoreve, praktikave klinike të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e tij.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë konform udhëzimeve të marra nga Ministria Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar si dhe udhëzimet respektive të MAS. Stafi akademik është përzgjedhur me kujdes të veçantë për çdo departament. Në programin e studimit “Master i

Shkencave ne Stomatologji ” rreth 78 % e ngarkesës mësimore përballohet me staf mësimor efektiv.

Titullaret e lëndëve plotësojnë një format bazë të syllabusit të institucionit që shpërndahet nga Departamenti, në bazë të kurrikulës. Pedagogu propozon brendinë apo ndryshimet e mundshme në syllabus. Në formatin e syllabusit të secilës lëndë janë të paraqitur në mënyrë të detajuar: qëllimi i lëndës, objektivat, bibliografia e detyrueshme, bibliografinë e rekomanduar etj.

Vlerësimi i studentit është gjithë përfshirës (semestral, vjetor). Mënyra e vlerësimit të studentëve është e përshkruar në mënyrë të detajuar në syllabusin e çdo lënde . Nota përfundimtare bazohet mbi vlerësimin e studentit në çdo komponent të mësimdhënies: leksione, seminare, laboratore/ushtrime, praktika laboratorike, projekte, si dhe provimi përfundimtar. Provimi përfundimtar zë përqindjen më të madhe të pikëve në vlerësim. Çdo student ka kartën e studentit për 5 vitet e studimeve.

Studentët janë të angazhuar në komponentët e aktivitetit të departamentit si punime shkencore individuale të pedagogëve, projekte shkencore në rang departamenti , projekte shkencore në rang Fakulteti .

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

GVJ mbështetur në vizitën në Institucion, dokumentacionin e dorëzuar konstaton se nuk ka ndryshime për këta tregues nga të dhënat në RVB.

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
  - Leksione
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj
    - Format e kontrollit të njohurive
    - Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

## 9. Studentët

GVJ u njoh me kriteret që UAL aplikon për pranimin e studentëve të cilat janë :

- Pranohe për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave, shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë këto kushte:

i. vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (barasvlerësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit);

ii. plotësojnë kushtet e tjera të pranimit, të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Shkollës së Lartë;

iii. pranojnë pagimin e tarifës së caktuar mujore ose vjetore.

- Numri i pranimeve bazohej në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

- Lejohej transferimi i studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta/universitetet, vendase ose të huaja, publike ose private, në UAL dhe anasjellas dhe brenda programeve të studimeve të Universitetit, pasi të bëhet barasvlerësimi i provimeve, sipas planeve mësimore përkatëse. Ky transferim bëhej i mundur pas c`rregjistrimit të studentit nga programi studimor ku ishte i regjistruar.

GVJ u njoh me procedurën e pranimit të studentëve të rinj në vitin e parë. Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, bëhet në bazë të rezultateve të arritura në arsimin e mesëm. Kur numri është më i madh se mundësitë e pranimit, zhvillohet konkurs. Përzgjedhja e studentëve kryhej nga një Komision i posaçëm i krijuar me Urdhër të Presidentit të Institucionit. Kandidatet fitues fitojnë statusin e studentit kur ata rregjistrohen në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave Dentare brenda afatit të caktuar.

Cilësia në hyrje në programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” nga viti në vit ka ardhur në rritje nga 7,25 në vitin akademik 2011-2012 në 8,59 në vitin 2016-2017. Ka një tendencë në dukje të rritjes së notës mesatare në hyrje të studentëve.

Nota mesatare në përfundim të studimeve ka një rënie të lehtë krahasuar me notën mesatare në hyrje të studimeve. Nga viti në vit është rritur numri i studentëve që i përfundojnë studimet brenda ciklit 5-vjeçar pa përsëritje të vitit. Vihet re rritje e kalueshmerisë nga viti në vit.

Institucioni dispononte të dhëna në lidhje me punësimin e të diplomuarve. Jo të gjithë studentët e diplomuar punësoheshin në përputhje me diplomën. Raporti i të diplomuarve me të punësuarit në lidhje me diplomën ishte 2:1.

Universiteti Aldent pranonte edhe studentë të cilët dëshironin të vazhdonin studimet e filluara në ndonjë universitet tjetër shqiptar apo të huaj, publik dhe jopublik. Në këto raste krijohej një Komision Vlerësimi me urdhër të Rektorit, pranë departamentit përkatës. Studentët e Universitetit Aldent lejoheshin të c`regjistrohen dhe të vazhdojnë studimet në një universitet tjetër. Ç`regjistrimi kryhej vetëm në fund të vitit. (Neni 20, Statuti i Universitetit).

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

GVJ mbështetur në vizitën në Institucion, dokumentacionin e dorëzuar konstaton se nuk ka ndryshime për këta tregues nga të dhënat në RVB.

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- etj

*Vlerësimi sipas Standardeve*

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriteve të pranimit.</p>	<p>GVJ konstaton se pranimi i studentëve të rinj në programin “Master i Shkencave ne Stomatologji ” bëhet sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Studentët që pranohen në këto program studimi plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga MAS dhe vetë institucioni.</p> <p>Në përfundim të ciklit të dytë të integruar studentët duhet të kenë mbrojtur edhe provimin e gjuhës së huaj. Cdo vit kriteret e pranimit rishikohen nga institucioni në mënyre që të rritet cilësia e studentëve në hyrje të programit të studimit.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se: Studentët informoheshin për akreditim e institucionit dhe programeve përkatëse si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion .</p> <p>Ky informacion është i publikuar edhe në faqen zyrtare të UAL dhe në katalogun e universitetit i cili i jepet cdo student që ka dëshirë të vazhdojë studimet pranë UAL.</p> <p>Ne UAL funksiononte Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila</p>



	organizonte leksione të hapura, seminare profesionale ku studentët e informohen për mundësitë e punësimit pas diplomimit.
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	Institucioni dispononte statistika për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar, të larguar, të diplomuar në ciklet përkatëse të studimit, të transferuar Disponohen të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve nga pranimi deri në diplomim.
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	Institucioni dispononte të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve në përfundim të studimeve. Universiteti Aldent në dy vitet e fundit ka krijuar një rrjet online ku studentët e diplomuar janë pjesë përbërëse e tij dhe ndajnë eksperiencat e tyre. Përfaqësuesit e zyrës Alumni organizojnë takime të herëpashershme me ish studentët e UAL dhe studentët e viteve të larta.
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se studentet informoheshin në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Pedagoget diskutonin me studentët për rezultatet e vlerësimit.
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Konstatuam se institucioni u ofron këshillim karriere gjithë studentëve, që realizohet nga zyra e ngritur për këtë qëllim dhe i ndihmon në zgjedhjet e klinikave dentare ku ata do të kryejnë praktiken profesionale.</p> <p>Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor nëpërmjet sistemit të tutoriatit.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>GVJ konstaton se pranimi i studentëve të rinj në programin “Master i Shkencave në Stomatologji ” bëhet sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji ” që ofron dhe me politikat e punësimit për të cilat funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Institucioni dispononte statistika për numrin e studentëve të rregjistruar, të çrregjistruar, të larguar, të diplomuar, të transferuar për programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji ”</p> <p>Disponohen të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve nga pranimi deri në diplomim. Në institucion funksionon sistemi i tutoriatit , ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor , angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

Universiteti Aldent përveç procesit mësimor është i angazhuar edhe në kërkimin shkencor. Nga anëtarët e departamentit të Stomatologjisë janë bërë një numër i madh botimesh në revista brenda vendit dhe jashtë vendit me faktor impakti. Po ashtu janë realizuar një numër i madh referimesh prezantime poster në kongrese dhe konferenca ndërkombëtare .

Infrastruktura e pasur me laboratore (27 gjithsej) të pajisur me aparatura bashkëkohore dhe me materiale cilësore për realizimin e eksperimenteve apo të metodave të reja mjekuese është në shërbim të kërkimit shkencor. UAL ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në disa projekte si për shembull "The role of dental health profession in recognition of child neglect" i cili do të fillojë zbatimin në vitin 2017.

Vetë institucioni ka realizuar aktivitete shkencore edhe për studentët e këtij program studimi, si për shembull Konferencën informuese të bashëpunimit me Universitetin e Chieti-Pescara, Itali, në Janar 2015, Konferencën e I-rë studentor në Maj 2016, Seminare të akredituara nga QKEV-ja, Trajnim në Gjermani të stafit dhe studentëve, etj.

Po ashtu ka qenë bashkëorganizatore dhe pjesëmarrëse në Kongresit e 4-t Mbarëkombëtar Shqiptar në Nëntor, 2015, Konferenca e 22-të e Kombëtare Dentare, Nëntor 2016 , në Simpoziumin e 2-të dhe të 3-të të Ortodontisë, me pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve etj. Ka patur rastë të vlerësimit të punës shkencore të UAL, si një studentë e specializimit Aida Meto ka marrë cmim nga Harvard University.

### ***Vlerësimi i Treguesve të matshëm:***

GVJ pas vizitës në institucion dhe dokumentacionin përkatës konstaton se nuk ka ndryshime të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Të dhëna për kërkimin shkencor jepen në tabelën 26 të RVB.

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit

- 1.Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL- 120
- 2.Numri i projekteve kërkimore të fituara- 2
- 3.Numri i projekteve të zbatuara- 3
- 4.Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit- 31
- 5.Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL- I madh
- 6.Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor ---
- 7.Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor - 10
- 8.Numri i Çmimeve Kombëtare - 1

### ***Vlerësimi sipas Standardeve***

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Dentare publikon artikuj në revista brenda dhe jashtë vendit dhe merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare , kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera .
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Mësimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Stomatologji ” zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe. Studentëve u vihet vëmendje në dispozicion literaturë bashkëkohore të huaj në bibliotekë dhe bibliotekën online.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e	UAL u jep një rëndësi të veçantë kualifikimit të vazhdueshëm profesional të personelit akademik duke nxitur dhe mbështetur financiarisht pjesëmarrjen aktive në organizime shkencore brenda dhe jashtë vendit.

kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Ky institucion disponon një bazë të dhënash të veprimtarisë shkencore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Çdo pedagog ka dosjen e tij me veprimtarinë shkencore, dosje e cila përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Këto të dhëna gjenden edhe online në faqen zyrtare të UAL.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>GVJ nga vizita në institucion dhe dokumentacioni, konkludon se personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Dentare publikon artikuj në revista brenda dhe jashtë vendit dhe merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare , kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera .Institucioni është i angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij duke e nxitur dhe mbështetur financiarisht.</p> <p>Ky institucion disponon një bazë të dhënash të veprimtarisë shkencore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion, konstatojmë se një nga prioritetet kryesore të Universitetit Aldent është bashkëpunimi me institucione homologe dhe krijimi i partneriteteve brenda dhe jashtë vendit. Për këtë, Universiteti Aldent ka hartuar plan afatshkurtër dhe afatmesëm me Universitete , institucione , kompani prodhuese dhe organizata vendase dhe të huaja. Ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Gabriele d’Annunzio”, të Chietit, Itali në dhjetor 2014, marrëveshje me qendrën Spitalore “San Giovanni XXIII”, Monastier, Treviso, Itali, marrëveshje me seksionin e edukimit të kompanisë 3M ESPE. Ndërkohë, ka bashkëpunuar dhe është në proces bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë, Spitalin e Traumës, Qendrën Spitalore Nënë Tereza, SHDSH, SHOSH, Bashkinë Tiranë, Farmaci Private, Qendrën e Dhimbjes, Kompaninë Trimed, Banka të ndryshme, televizione lokale. Në Aldent janë organizuar workshope, trajnime, prezantime duke përfshirë aktivisht dhe studentët.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konstaton se nuk ka ndryshime me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB)(tabela 27) për këta tregues.

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare-8
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj -400 ore
- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit-21
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL-

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime- 50
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Aldent ka marrëdhënie bashkëpunimi për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve “Master Profesional” dhe “Master Shkencor” me: Shoqërinë “Dental Leader Corsi” SH.P.K, kompaninë 3M ESPE, komunitete biznesi, me klinika dentare private, Shoqërinë e Sigurimit ALBSING SHA, Banka Veneto Bank.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime</p>	<p>GVJ i njohur me dokumentacionin përkatës, konstaton se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Institucioni organizon trajnime profesionale të metejshme në kuadër të edukimit në vazhdimësi në bashkërendim me punëdhënësit;</p>

profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;  
**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ konkludon se institucioni nxit dhe ka krijuar kushte për bashkëpunimin mes personelit të tij dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe jashtë dhe brenda vendit.

**I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

**a. Pika të forta:**

1. Programi i studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji ” është në përputhje me misionin dhe qëllimin etij. Ai ofrohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Kurikula e programit të studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji ” është bazuar në praktikën më të mira europiane duke patur parasysh kompetencat e dentistit ne Bashkimin European kombëtare,specifikat dhe kriteret për profesionet e rregulluara në vendin tonë.
3. Personeli akademik,ndihmës mësimor -shkencor dhe administrativ është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e objektivave të këtij programi.
4. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikim akademik dhe profesional dhe luan rol kryesor në hartimin e kurikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programit të studimit.
5. Institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme (salla leksionesh,klasa,laboratorë ,bibliotekë) për realizimin e programit të studimit ”Master i Shkencave në Stomatologji”.
6. Kriteret e pranimit te vendosura nga MAS dhe kriteret specifike përzgjedhëse te institucionit kane cuar ne rritjen e cilesise se studentëve në hyrje.
7. Institucioni i mbështet dhe i përfshin vazhdimisht studentët në aktivitetet shkencore brenda dhe jashtë vendit.
8. Studentet e diplomuar kane kalueshmëri të lartë në provimin praktik dhe teorik te liçencimit çka dëshmon për aftësimin e tyre teorik dhe praktik gjatë programit të studimit.
9. Studentët e vitit të III,IV,V-të në praktikën klinike të protetikës,ortodontisë,krurgjisë OMF- së,terapisë,dentistrisë pediatrike, ofrojnë shërbime falas për komunitetin.
10. Institucioni është i angazhuar për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në realizimin e programit të studimit ”Master i Shkencave ne Stomatologji”

11. Institucioni organizon konferenca, seminare, work shop-e në kuadër të kërkimit shkencor me pjesëmarrje aktive të pedagogëve dhe studentëve.
12. UAL bashkëpunon me Universite, shoqata dentare, firma dentare, klinika dentare.
13. Institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash ( të rekrutimit, të pranimeve, transferimeve, veprimtarisë shkencore, të rezultateve të studenteve, financiare etj)

**b. Pika të dobëta:**

1. Mungesë e të ardhurave të realizuara nga burime financiare alternative nga projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Mobiliteti i studenteve dhe stafit akademik me homologët jashtë vendit.
3. Mbingarkesa e udhëheqësve të temave të diplomave të studentëve (7 diploma për pedagog)
4. Mungesa e mjediseve të hapura sportive

**c. Mundësitë:**

1. Përmirësimi i mëtejshëm i programit në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë dhe zhvillimet e reja në fushën e dentistrisë
2. Asistencë ndaj stafit akademik për kualifikimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit.
3. Kreditet e parashikuara për tezën e diplomës të jenë konform kriterit (30-40 kredite)
4. Aplikime për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për financime në infrastrukturë në funksion të programit dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve.
5. Zhvillimi i politikave favorizuese nga ana e Qeverisë në drejtim të arsimit të lartë e veçanërisht drejt nxitjes së cilësisë në këtë fushë.
6. Iniciativa e Qeverisë për futjen e IAL private në skemën e financimit nga financat publike.
7. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneritetet aktuale krijojnë siguri dhe premisa për partneritete të reja, zhvillimin e kërkimit shkencor, shkëmbim eksperience, shkëmbim stafi e studentësh dhe mundësi për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare.

**d. Pengesat:**

1. Mbështetja e ulët financiare dhe logjistike nga institucione shtetërore apo donatorë.
2. Ky program studimi ben pjesë në profesionet e rregulluara dhe numri i studenteve është i kufizuar duke mos i dhënë mundësi institucionit të rrisë kapacitetet financiare të cilat shërbejnë për rritjen e mëtejshme të cilësisë.

3. Aparaturat dentare bashkëkohore, materialet dentare në funksion të programit të studimit kanë kosto të lartë financiare.

**4. COMPREHENSIVE ANALYSIS BY THE EXTERNAL EVALUATION REPORT OF SWOT APPROACH (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

**a. Strengths:**

1. The study program "Master of Science in Dentistry" is consistent with the mission and its purpose. It is provided in accordance with the laws and regulations in force.
2. The curricula of the study program "Master of Science in Dentistry" is based on the best European practices taking into account the competences of the European Union dentist, specifications and requirements for regulated professions in our country.
3. Academic, scientific-educational and administrative personnel is fully committed to the objectives of this program.
4. The academic staff engaged in this study program has academic and professional qualifications and plays a key role in drafting the curricula and institutional decisions that belong to the organization of the study program.
5. The institution has provided the necessary infrastructure ( lecture halls, classrooms, laboratories, library) for the realization of the study program "Master of Science in Dentistry".
6. The admission criteria set by the Ministry of Education and Science and specific selection criteria of the institution have led to the increased quality of incoming students.
7. The institution continuously supports and includes students in scientific activities, inside the country and abroad.
8. Graduated students have a high level of passing in theoretical and practical examination of licensing which indicates their good training in theoretical and practical study program.
9. Students of third, fourth and fifth year, in clinical practice of prosthetics, orthodontics, OMF surgery, therapy, pediatric dentistry, offer free services to the community.
10. The institution is committed to continuous quality assurance in the realization of the study program "Master of Science in Dentistry"
11. The institute organizes conferences, seminars, work-shops regarding to scientific research with active participation of teachers and students.
12. UAL cooperates with universities, dental associations, dental firms, dental clinics.
13. The institution has a complete data base ( of recruitment, admissions, transfers, scientific activity, of finance, results of students , etc.)





**b. Weaknesses:**

1. Lack of income derived from alternative financial resources from various national and international projects.
2. Mobility of students and academic staff with homologous abroad.
3. Overloading the leaders of students' diploma theses (7 theses for one pedagogue).
4. Lack of open sports facilities.

**c. Opportunities :**

1. Further improvement of the program in accordance with the new law of higher education and new developments in the field of dentistry.
2. Support to academic staff for continuing education inside the country and abroad.
3. Provided credits for diploma thesis conform to criteria (30-40 credits)
4. Applications for national and international projects for funding in infrastructure in function of the programme and mobility of the staff and students.
5. The development of favorable policies by the Government in terms of higher education, especially towards promoting quality in this field.
6. Initiatives of the Government for the introduction of private HEIs in the scheme of financing from public finances.
7. International cooperation and current partnerships provide security and premises for new partnerships, development of scientific research, exchange of experience, exchange of students and staff and opportunities to participate in international projects.

**d. Threats:**

1. Little financial and logistical support by state institutions or donors.
2. This study program is part of the regulated professions and the number of students is limited, by not enabling the institution to increase the financial capacities that serve to further increase of the quality.
3. Modern dental apparatus, dental materials in function of the study program have a high financial cost.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof.Asoc Etleva Qeli (Droboniku),**

**Dr.Shk Manola Kelmendi**

